

# **Banka Credins sh.a.**

**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
(shuma në mijë Lekë, përvèç kur është shprehur ndryshe)

## **1 Të përgjithshme**

Banka Credins SHA (këtëj e tutje "Grupi") është një institucion finansiar Shqiptar i themeluar më 1 janar 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Grupit në Republikën e Shqipërisë", miratuar në Korrik 1998. Grupi është gjithashu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në dhjetor 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë" (këtëj e tutje referuar si "Banka Qendrore").

Me 31 dhjetor 2019, Grupi ushtronte aktivitetin e tij nëpërmjet drejtorisë së përgjithshme të tij në Tiranë, 50 degëve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Shijak, Shkozë, Kavajë, Lushnje, Fushë Krujë, Kukës, Burrel, Ballsh, Berat, dhe Peshkopi si dhe 8 agjencive në Tiranë, Shkodër dhe Durrës (31 dhjetor 2018: 50 degë dhe 8 agjencie).

Grupi Credins Bank Sh.a përbahet nga Credins Bank Sh.a në cilësinë e mëmës, "CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëria administruuese e Fondave të Pensioneve dhe Sipermarrjeve të Investimeve Kolektive, ku Credins Bank zotëron 76% të aksioneve, "Regjistr Shqiptar i Tituve ALREG" sh.a. ku Credins Bank Sh.a zotëron 52,5% të aksioneve dhe "Bursa Shqiptare e Tituve ALSE" sh.a." ku Credins Bank Sh.a zotëron 42,5% të aksioneve."

Më 31 dhjetor 2019 Grupi kishte 934 punonjës (31 dhjetor 2018: 883 punonjës).

Adresa e zyrave qendrore të bankës dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rrugë "Vaso Pasha," Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

## **2 Bazat e përgatitjes**

### **2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përvèç aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes dhe përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, të matura me vlerë të drejtë dhe pronave të riposeduara të matura me më të voglën ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Grupit. Përvèç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në mijë LEK, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

#### **2.1.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

#### **2.1.2 Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara**

Grupi e paraqet pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente), dhe më vonë se 12 muaj nga data e raportimit (jo korrente) paraqitet në shënimin 34.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Grupi gëzon të drejtëligjore për të bërrë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet nuk paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifikë në politikat kontabёl të Grupit. Janë bërrë disa riklasifikime nga viti kaluar për tu prezantuar më mirë me klasifikimin aktual.

#### **2.1.3 Bazat për konsolidimin**

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të Mëmës dhe filialeve të saj më 31 dhjetor 2019. Kontrolli arrihet kur Mëma ekspozohet, ose i lind e drejta të përfitojë nga përfshirja e tij në filial, të ardhura të cilat mund të jenë të variushme, si dhe nëse ka aftësinë të afektojë këto rezultate nëpërmjet ndikimit të tij mbi filialin.

Specifiktisht, Mëma kontrollon një filial, nëse dhe vetëm nëse, Mëma ka:

- Ndikim mbi filialin (p.sh: të drejta ekzistuese që i jepin mundësinë të drejtojë aktivitetet kryesore të filialit)
- Ekspozim ose i lind e drejta e përfitorit të rezultateve si rrijedhojë e përfshirjes së saj në filial
- Aftësinë për të ushtruar ndikimin e saj mbi filialin, për të ndikuar mbi rezultatet e ardhshme

# **Banka Credins sh.a.**

**Shënimë për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
(shuma në mijë Lekë, përvet kur është shprehur ndryshe)

## **2. Politikat kontabel (vazhdim)**

### **2.2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

#### **2.1.3 Bazat për konsolidimin (vazhdim)**

Përgjithësisht, prezumohet që kush ka shumicën e të drejtave të votës, ushtron kontrollin. Për të mbështetur këtë supozim, si dhe në rastet kur Mëma nuk ka shumicën e të drejtës së votës mbi një filial, Mëma konsideron të gjithë faktoret dhe rrethanat përfshirë nëse ka ndikim mbi filialin, të tillë si:

- Marrëveshjet kontraktuale me të tjerë aktionere që kanë të drejtë vote në filial
- Të drejtë të cilat vijnë nga marrëveshje të tjera kontraktuale
- Të drejtat e votës së Grupit si dhe të tjera të drejtë vote të mundshme

Mëma rivlerëson fakin nëse ajo kontrollon ose jo një filial, në bazë të fakteve dhe rrethanave të cilat diktojnë që mund të ketë ndryshime në një ose më shumë elemente të kontrollit. Konsolidimi i filialeve fillon kur Mëma merr kontrollin dhe mbaron kur Mëma e humbet këtë kontroll mbi filialin. Aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e filialit të blerë ose të shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data që Mëma merr kontrollin deri në datën kur ajo e humbet atë.

Fitimi ose humbja dhe çdo element i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse i përkasin aktionerëve të mëmës si dhe interesave jo-kontrollues, edhe në rastin kur kjo sjell si pasojë një interes jo-kontrollues negativ. Në rastet që gjykohet e nevojshme, bëhen rregullime në pasqyrat financiare të filialeve përfshirë së cilat politikat e tyre kontabël në linjë me politikat kontabël të përdorura nga Grupi. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, dhe aktivet, kapitali, te ardhurat dhe shpenzimet dhe flukset e parasë të lidhura me transaksione të ndodhura ndërmjet shoqërive të Grupit elemi të plotësish të konsolidim. Një ndryshim në interesin e zotëruar në një filial, që nuk sjell si pasojë humbjen e kontrollit, kontabilizohet si një transaksion me kapitalin.

Nëse Mëma humbet kontrollin mbi filialin, ajo rrëgjistron të gjitha aktivet (duke përfshirë edhe emrin e mirë), detyrimet, interesin jo-kontrollues si dhe elementë të tjerë të kapitalit, duke njojur në fitim ose humbje cdo rezultat nga rrëgjistrimi. Çdo investim i mbajtur njihet me vlerë të drejtë.

#### **2.1.4 Kombinimi i bizneseve dhe emri i mirë**

Kombinimi i bizneseve kontabilizohet duke përdorur metodën e blerjes. Kostoja e blerjes matet si shuma e të gjithë vlerës së transferuar, e cila matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes si dhe me vlerën e çdo interesit jo-kontrollues në shoqërinë e blerës. Për cdo kombinim biznesi, Grupi zgjedh nëse do ta masë interesin jo-kontrollues me vlerë të drejtë ose me pjesën proporcionale të tij në aktivet neto të identifikueshme të shoqërisë së blerës. Kostot e lidhura me blerjen përfshihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin dhe konkretisht në zërin shpenzime administrative.

Kur Grupi blen një biznes, ai vlerëson aktivet financiare dhe detyrimet financiare të marra, përkushtatshëm si dhe alokimin në përputhje me termat kontraktuale, rrethanat ekonomike dhe kushtet specifike në datën e blerjes. Çdo konsideratë e mundshme që do duhet të transferohet nga shoqëria blerëse, do të matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes.

Emri i mirë matet fillimisht me kosto (që rezulton nga tejkalimi i konsideratës së dhënë dhe vlerës së njojur për interesin jo-kontrollues) si dhe ndonjë interes tjetër mbi aktivet neto të identifikueshme dhe detyrimet e marra. Nëse vlera e drejtë e aktiveve neto të blera tejkalon shumën totale të konsideratës së transferuar, Mëma rrëvlerëson nëse i ka identifikuar saktë të gjitha aktivet e blera dhe të gjitha detyrimet e marra, si dhe rishikon procedurat e përdorura përfshirë së transferuar shumat përfshirë së transferuar. Nëse rrëvlerësimi rezulton sërisht në tejkalim të konsideratës së transferuar, atëherë fitimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Pas njoftes fillestare, emri i mirë matet me kosto duke i zbritur çdo zhvlerësim të akumuluar. Për qëllim të testimit të rënies së vlerës, emri i mirë i përfshirë nga kombinimi i biznesit, i alokohet çdo njësie gjeneruese të parasë së Grupit, që priten të përfitojnë nga kombinimi, pavarësisht nëse aktive dhe detyrimet e tjerë të shoqërisë së blerës i janë alokuar atyre.

#### **2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare të Grupit kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësimë dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar të të ardhurave, blerjeve, aktiveve dhe detyrimeve, si dhe shënimet shpjeguese shoqëruese, si dhe shënimet shpjeguese të detyrimeve kontigjente (nëse ka). Pasiguria rreth këtyre supozimeve dhe vlerësimeve mund të cojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve ose detyrimet e prekura në periudhat e ardhshme. Në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Grupit, Drejtimi ka bërë gjykimet dhe supozimet e mëposhtme në lidhje me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, që kanë një rrezik të rëndësishëm përfshirë së cilat përfshihen në rregullim material të vlerës së aktiveve dhe detyrimet brenda vitit tjetër kontabël.

Rrethanat ekzistuese dhe supozimet përfshirë së transferuar përfshirë së cilat përfshihen në rregullim material të vlerës së aktiveve dhe detyrimet brenda vitit tjetër kontabël.

# **Banka Credins sh.a.**

**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(shuma në mijë Lekë, përvèç kur është shprehur ndryshe)*

---

## **2. Politikat kontabel (vazhdim)**

### **2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

#### **2.2.1 Humbjet nga zhvleresimi per aktivet financiare**

Grupi konsideron ekspozimet si joperformues/te zhvleresuar kur ka ndodhur një ose me shume nga rrëthanat e meposhtme të cilat kane një ndikim perkeqesues ne mjetet monetare te prishme:

- Ditet ne vonese per një llogari me shume se 90 dite,
- Kredia eshte e kategorizuar nga një vleresim ne renie (kredi qe kane një vleresim të barabarte me 7 ose një vleresim ekonomik të barabarte me 10)
- Kredia eshte subjekt i një ekspozimi baze per zhvleresim individual ne nivel GCC

Perkuqizimi i voneses së permendor më siper (zhvleresimit) përdoret në nivel llogarie (kredie).

Kredite të cilat nuk janë të testuara individualisht për zhvleresim vlerësohen kolektivisht. Në zhvleresimin kolektiv përfshihen gjithashtu edhe kredite qe kane një ekspozim me pak se 10,000 mijë leke ne nivel GCC.

Zhvleresimi kolektiv llogaritet ne lidhje me stadin 1 dhe 2.

Stadi 2: Per llogarite e testuara kolektivisht fondi i zhvleresimit eshte e njejtë me Humbjet e Prishme (ECL) të gjithe jetes (kohezgjatjes) së kredisë. ECL e gjithe jetes përcaktohet si humbja e të gjitha eventeve të mundshme per gjate gjithe jetes së një instrumenti financiar (p.sh. reziku i daljes në vonese që ndodh në një instrument financiar gjatë jetës së prishme të tij).

Stadi 1: Per llogarite e testuara ne grup (kolektiv) ne Stadin 1, llogaritet ECL 12 mujore. 12-muaj ECLs eshte humbja qe pritet të materializohet në 12 muajt ne vijim – kështu probabiliteti 12 mujor shumezohet me Ekspozimin në Risk (EAD) aktuale dhe Humbja e Ndodhur (LGD) koresponduese. Ne rastet kur maturiteti i mbetur eshte me pak se 12 muaj, në vend të Propabilitetit të Dështimit (PD) 12 mujore përdoret PD e gjithe jetes.

Matja e humbjeve nga zhvleresimi sipas SNRF 9 në të gjitha kategoritë e aktiveve financiare të përfshira kërkon gjykimin, në veçant, vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme dhe vlerave të kolateralit gjatë përcaktimit të humbjeve nga zhvleresimi dhe vleresimit të një rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë. Këto vlerësimë janë të nxitura nga një numër faktorësh, ndryshime në të cilat mund të rezultojnë në nivele të ndryshme të zhvleresimit.

Llogaritjet ECL të Grupit janë rezultatet e modeleve komplekse me një numër supozimesh themelore të zgjedhura në inputet e ndryshueshme dhe ndërvarësive të tyre. Elementet e modeleve ECL që konsiderohen gjykime dhe vlerësimë kontabël përfshijnë:

Modeli i brendshëm i klasifikimit të kredive të Grupit, i cili cakton PD-të në nivelet individuale

- Kriteret e Grupit për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë dhe kështu që lejimet për aktivet financiare duhet të maten në bazë të Humbjeve të Prishme Përgjatë Jetës (LTECL) dhe vlerësimi cilësor
- Segmentimi i aktiveve financiare kur ECL-ja e tyre vlerësohet në baza kolektive
- Zhvillimi i modeleve ECL, duke përfshirë formulat e ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve.
- Përcaktimi i lidhjeve midis skenarëve makroekonomikë dhe inputeve ekonomike, siç janë nivelet e papunësisë dhe vlerat e kolateralit, si dhe efektet në PD, EAD dhe LGD
- Përzgjedha e skenarëve makroekonomikë të parashikuar nga pikëpamjet dhe koeficientet e tyre të probabilitetit, për të njëjrrë inputet ekonomike në modellet ECL
- Përzgjedha e skenarëve makroekonomik forward-looking dhe pesha e tyre e probabilitetit, per të perfshire inputin ekonomik në modellet e ECL.

Ka qenë politika e Grupit për të rishikuar rregullisht modelet e saj në kontekstin e përvjës aktuale të humbjes dhe përshtatur kur është e nevojshme.

#### **2.2.2 Parimi i vijimësisë**

Gjatë fillimit të vitit 2020, në nivel global u përhap pandemia e COVID-19. Që prej 31 dhjetorit 2019, pasojat e COVID-19 kanë prekur negativisht ofertën dhe kërkesën e produkteve kryesore të Grupit, dhe për rrjetin, rezultatet operative të saj janë ndikuar negativisht. Në mars të vitit 2020, qeveria e Shqipërisë mori masa drastike duke pezulluar të gjitha aktivitetet që nuk ishin jetësore. Megjithatë, aktivitetet e bankave nuk u ndërprenë. Pandemia ka sjellë vonesa në disa prej klientëve të Grupit. Qeveria njoftoi përsigurimin e një garancie sovrate për të gjitha bizneset të cilat po përballen me probleme të likuiditetit dhe ato që do të kenë nevojë përfshirë financim. Për më tepër, Banka e Shqipërisë ka njoftuar se klientët që do të përballen me probleme të likuiditetit mund të kërkojnë shtyrjen e shlyerjes së detyrimeve të tyre ndaj Bankave për një periudhë 3 mujore.

Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i masave të qeverisë dhe bankës qendrore, mbeten i paqartë ende në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Grupit përiudhat e ardhshme.

## **Banka Credins sh.a.**

## **Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 (shuma në mijë Lekë, përvèc kur është shprehur ndryshe)**

## **2. Politikat kontabel (vazhdim)**

## 2.2 Përdorimi i ylerësimeve dhe qiykimeve (vazhdim)

### **2.2.2 Parimi i vijimësisë (vazhdim)**

Aktiviteti i Grupit ka vazhduar pa ndërprerje gjatë vitit 2020, dhe ka pasur një performancë relativisht të qëndrueshme në mbledhjen e të arkëtueshmeve prej klientëve. Për fundin e vitit 2020, Grupi pret një rritje të portofolit të kredive jo-performuese për shkak të rënies ekonomike. Pas shfaqjes së emergjencës të pandemisë COVID-19, Grupi po analizon ndryshimet makroekonomike dhe do të pasqyrojë këto ndryshime në Stress-testet e përdorura për të përshkruar ndikimin e COVID-19 në llogaritjen e Humbjeve të Pritshme të Kredisë.

Grupi konsideron në vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të saj të brendshëm skenarin e stresit në llogaritjen e kërkesës së kapitalit për rrezikun e tregut në lidhje me portofolin e tij të investimeve, shumica e të cilave matet me vlerën e drejtë përmes të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në kapital. Humbjet e parealizuara mund të shndërrohen në humbje të realizuara, në rastin e një pjese ose të gjithë portofolit, do të klasifikohen në portofolin e tregtueshmëri ose do të shiten potencialisht në treg. Luhatja në vlerat e drejta pritet të ketë ndikim më të ulët në rezultatet e bankës për shkak të madhësisë së vogël të portofolit të Grupit të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Grupi e konsideron rrezikun e likuiditetit në planet e rimëkëmbjes, në procesin e vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit të brendshëm, duke vendosur kufij të përcaktuar mirë për kërkesën e saj për rrezik. Grupi vlerëson se burimet e saj kapitale janë të disponueshme.

Grupit kryen rregullisht analiza të stress-testeve me skenare bazë dhe të rënduar, për të testuar ndikimin e mundshëm të treguesve makroekonomikë në pozicionin financiar të saj, performancën dhe pajtueshmërinë rregullatore. Këto stress-teste janë përgjendruar kryesisht në ndikimin që disa skenarë makro dhe mikroekonomikë mund të kenë në portofolin e kredisë, duke qenë burimi kryesor i të ardhurave në pozicionin financiar të Grupit, përfshirë edhe rezikun e tregut. Në këto analiza janë përdorur modelet zyrtare të parashikimit të vlerësimit të rezikut të brendshëm të Bankës Qëndrore dhe Grupit. Ne skenarin bazë bazuar në veprimtarinë e bankës për 3 vitet e fundit, Banka parashikon një normë të RMK-së për vitin 2020 dhe 2021 prej 15,39%. Në skenarin e rënduar, Banka Banka parashikon një normë të RMK për vitin 2020 13,05% dhe një normë prej 11,07% për vitin 2021. Në skenarin e rënduar, Banka ka supozuar të shtojë në kërkesën përkapital mesataren e 5 humbieve më të mëdha të 5 viteve të fundit (2015 -2019).

Përsë i përket skenarëve të likuiditetit, Banka ka kryer stress-testet duke konsideruar skenarin për krizë likuiditeti specifike vetem për Bankën Credins dhe skenarin për krizë likuiditeti per sistemin bankar duke supozuar ulje të arkëtimeve me 20% dhe terheqje të depozitave nga 14% deri në 23%. Në të dy skenaret, Banka parashikon se, nëse situata e stresit të likuiditetit vazhdon për një periudhë 3 mujore, Banka e mbulon kërkesen për fonde për të 3 monedhat kryesore.

Janë kryer teste dinamike për të vlerësuar efektin e mundshëm të ndikimit të rritjes/pakësimit të klientëve tek zërat e ndryshëm të pozicionit financiar, dhe të ardhurave dhe shpenzimeve, për një periudhë të caktuar kohore.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 Grupi ia ka dale të arrijë rezultatet e buxhetuara. Për vitin që përfundon 2020, Grupi pret që të ketë një devijim negativ në arritjen e shifrave te buxhetuara për shkak të situatës Pandemike, megjithatë Drejtimi beson fuqimisht se do të arrijë të raportoi rezultate pozitive.

Drejtimi i Grupit ka bërë një vlerësim mbi aftësinë e Grupit për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e përmendur më lart dhe është konfident që Grupi ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, Drejtimi nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, Pasqyrat Financiare vazhdojnë të jenë të përgatitur në bazë vijimësie. Për shënimë shpjeguese shtesë mbi menaxhimin e kapitalit referonjuni shënimit 38.6.

### 2.2.3 Vlera e dreitë e instrumentave financiare

Vlera e drejtë e instrumentave financiarë është çmimi që do mund të mirej për shitjen e njëaktivi apo do paguhej për transferimin e një detyrimi në një transaksion normal në një treg të rregulluar (ose më i leverdisshëm) në datën e matjes në kushtet e tregut (p.sh., një çmim daljeje) pavarësisht nëse ai çmim është lehtësisht i obsevueshëm ose i vlerësuar nëpërmjet teknikave të vlerësimit. Kur vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që nijhet në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të nxirret nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një varietet të teknikave të vlerësimit që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele meren nga tregje të observueshme kur është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, kërkohen vlerësimë për përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijne marjen nën konsideratë të likuiditetit dhe modeleve të inputeve që lidhen me zëra të tillë si riziku i kredisës (të vetes dhe të pales jetës), financimi i regulillimeve të vlrës, korelacioni dhe ndryshueshmëria. Për më shumë detaje mbi përcaktimin e vlerës së drejtë referojmë shënimin 2.4.3.

#### **2.2.4 Metoda e Normës Efektive të Interesit**

Metoda e Normës së Interesit Efektiv të Grupit, sikurse shpjegohet në shënimin 2.4.7.1, njeh të ardhurën nga interesit duke përdorur një një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një norme konstante kthimi përgjatë jetës së pritshme të kredive dhe depozitave dhe njeh efektin e një norme potenciale interesit të ndryshme që i ngarkohet në stade të ndryshme si dhe karakteristikave të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet dhe shpenzimet dhe penalitetet). Ky vlerësim, nga natyra, kërkon një element gjykimi në lidhje me sjelljen e pritshme dhe ciklin e jetës së instrumentit.

# **Banka Credins sh.a.**

**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
(shuma në mijë Lekë, përvëç kur është shprehur ndryshe)

## **2. Politikat kontabel (vazhdim)**

### **2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

#### **2.2.5 Përcaktimi i kushtave të qirasë për kontratat e qirasë me opsonin e rinvimit apo përfundimit (Grupi si qiramarrëse)**

Grupi përcakton kushtet e qirasë si kushtet e pa-anullueshme të qirasë, sëbashku me periudhat e mbuluara nga opzioni për shtyjen e qirasë nëse është në mënyrë të arsyeshme e sigurtë që do të ushtrohet, ose ndonjë periudhë të mbuluar nga opzioni për ta përfunduar qiranë, nëse është në mënyrë të arsyeshme e sigurtë që nuk do ushtrohet.

Grupi ka disa kontrata qiraje që përfshijnë opsonin e përfundimit apo rinvimit. Grupi aplikon gjykimin në vlerësimin nëse është e sigurtë apo jo që do të ushtrojë opsonin për ta rinvuar apo përfunduar qiranë. Dhëne kjo, ai konsideron të gjithë faktorët që ndikojnë për të krijuar një nxitje ekonomike për të, për të ushtruar ose rinvimin ose përfundimin. Pas dates së fillimit, Grupi rivlerëson kushtet e qirasë nëse ka një ngjarje ose ndryshim të rëndësishëm në rrëthanat që janë nën kontrollin e saj që ndikon aftësinë e tij për të ushtruar ose jo opsonin e rinvimit ose përfundimit (p.sh., ndërtimi i një mase të rëndësishme të "përmirësimeve të ambienteve me qira" ose një ndryshimi specifik të rëndësishëm të aktivit me qira) ose çdo ngjarje tjeter që ndalon Grupin të përdorë ambjetet.

#### **2.2.6 Vlerësimi i normës rritëse të borxhit**

Grupi nuk mund të përcaktojë lehtësisht normën e brëndshme të nënkuptuar të qirasë, dhe për rrjedhojë, ai përdor normën rritëse të borxhit (NRB) për të matur detyrimet e qirasë. NRB është norma e interesit që Grupi do të duhet të paguante nëse do merte një borxh me kushte të ngashme, dhe me siguri të ngashme, fondet e nevojshme për të siguruar një aktiv më vlerë të ngashme me aktivin e drejtë-në-përdorim në një mjedis ekonomik të ngashëm. NRB në këtë mënyrë pasqyron atë çfarë Grupi "do të paguante", gjë e cila kërkon vlerësim kur nuk ka të dhëna të observueshme (të tilla si filialët të cilat nuk hyjnë në transaksione financiare) ose kur nevojiten të rregullohen për të reflektuar kushtet dhe termat e qirasë (për shembull, kur qiratë nuk janë në monedhën funksionale të filialit). Grupi vlerëson NRB duke përdorur inpute të observueshme (të tilla si normat e interesit të tregut) kur janë të disponueshme dhe kërkohet të bëhen disa rregullime specifike për entitetin (të tilla për të reflektuar termat dhe kushtet e qirasë).

#### **2.2.7 Zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë**

Grupi shqyrton letrat e tij të borxhit të klasikuara si investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje në çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paradhënieve.

Trajtimi i instrumenteve financiare (obligacionet qeveritare dhe ekspozimet me bankat) eshte ndryshe nga trajtimi i pergjithshem ne lidhje me percaktimin e parametrave. Nderkohe qe LGD bazohet në diferençën midis flukseve të kontraktuale të mjeteve monetare dhe atyre që huadhenësi do të priste te merrte (sipas rregullave CRR), Probabiliteti i voneses (PD) lidhet me vlerësimin e shtetit sipas S&P.

Mqs nuk ka pasur perkeqesim të rëndësishëm në rezikun e kredisë për vlerën e portofolit të letrave me vlerë është illogaritur vetem PD 12 mujore kumulative.

## **2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet**

### **2.3.1 Standarde të reja dhe të rishikuara dhe interpretime**

Grupi aplikoi për herë të parë disa standarde dhe ndryshime, të cilat janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Grupi nuk ka miratuar më herët ndonjë standard, interpretim ose amendim tjeter që është lëshuar por nuk është ende efektiv.

Në këto pasqyra financiare, Grupi ka aplikuar SNRF 16 Qiratë për here të parë. Natyra dhe ndikimi i ndryshimeve si rezultat i adoptimit për herë të parë të këtij standarti të ri përshtkuhen në Shënimin SNRF 16 – Qiratë më poshtë. Ka disa amendime dhe interpretime që aplikohen për here të parë në 2019, por këto nuk kanë ndikim mbi pasqyrat financiare të Grupit.

Natyra dhe efekti i këtyre ndryshimeve janë dhënë më poshtë. Natyra dhe ndikimi i çdo standardi të ri ose ndryshimi përshtkuhet më poshtë:

- SNRF 16 – Qiratë**

SNRF 16 zëvendëson SNK 17 Qiratë, IFRIC 4 Përcaktimi nëse një anagazhim përban një qira, SIC-15 Qiratë operacionale – Incentivat dhe SIC-27 Vlerësimi i Thelbit në transaksionet që përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje. Standarti paraqet parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpalosjet për qiratë dhe kërkon që qiramarrësit të njohin shumicën e qirave në bilanc.

Kontabiliteti i qiradhënsit nuk ka ndryshime thelbësore nga ato të SNK 17. Qiradhënsit do vazhdojnë ti klasifikojnë qiratë ose si qira financiare ose si qira operacionale si në SNK 17. Rrjedhimisht, SNRF 16 nuk pati ndikim për qiratë ku Grupi është qiradhëns.

Grupi adoptoi SNRF 16 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive me datën e aplikimit fillestar më 1 janar 2019. Nën këtë metodë, standarti aplikohet në retrospektivë me efektin kumulativ të aplikimit për herë të parë të standartit të njohur në datën e aplikimit fillestar. Grupi zgjodhi të përdorë përlashtimin tranzitor praktik të mos rivlerësimt nëse një kontratë është apo përban një qira më 1 janar 2019. Por, Grupi aplikoi standartin vetëm në ato kontrata që ishin më parë të identifikuara si qira me SNK 17 dhe IFRIC 4 në datën e aplikimit fillestar.

# Banka Credins sh.a.

Shënim për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
(shuma në mijë Lekë, përvèç kur është shprehur ndryshe)

## 2. Politikat kontabel (vazhdim)

### 2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

#### 2.3.1 Standarde të reja dhe të rishikuara dhe interpretime (vazhdim)

Grupi ka kontrata qiraje për degë të ndryshme dhe paisje IT. Përpara adoptimit të SNRF 16, Grupi i klasifikonte se cilën nga qiratë (si qiramarrëse) në datën e lidhjes si ose qira financiare ose qira operacionale. Referoju shënimit 2.4.26 për politikën kontabile para 1 janar 2019.

Me adoptimin e SNRF 16, Bank aplikoi një metodë njojje dhe matjeje për të gjitha qiratë përvèç qirave afatshkurtra dhe atyre për aktive me vlerë të ulët. Referoju shënimit 2.4.27 për politikën kontabile para 1 janar 2019. Standarti siguron kërkesa specifike tranzitore dhe burime praktike, të cilat janë përdorur nga Grupi.

#### • Qiratë të klasifikuara më parë si qira financiare

Grupi ka qira financiare për klientët e saj. Nuk ka pasur ndryshime për trajtimin e qirave financiare në krahasim me standartin e mëparshëm. Qiradhënësit do vazhdojnë ti klasifikojnë qiratë ose si qira financiare ose si qira operacionale si në SNK 17.

#### • Qiratë të kontabilizuara më parë si qira operacionale

Grupi njoihu aktive të drejta-në-përdorim dhe detyritme qiraje për ato qira të klasifikuara më parë si qira financiare, përvèç qirave afatshkurtra dhe aktiveve me vlerë të ulët. Aktivet e drejta-në-përdorim për shumicën e qirave është njojur bazuar në vlerën e mbartur njësoj sikur standri të ishte aplikuar gjithmonë, pavarësisht përdorimit të normës rritëse të borxhit në ditën e aplikimit të parë. Në disa qira, aktivet e drejta-në-përdorim janë njojur bazuar në vlerën e njëjtë të detyrit të qirasë, të regulluar për çdo parapagim apo detyrim qiraje të llogaritur që lidhet me të dhe të njoitura më parë. Detyritet e qirasë u njojhën bazuar në vlerën aktuale të flukseve të mbetur të pagesave së qirasë, skontuar duke përdorur normën rritëse të borxhit në datën e aplikimit filletar.

Grupi aplikoi gjithashtu mjetet praktike të gatshme kur mundej:

- Përdori një normë skontimi të vetme për një portofol qirash me karakteristika të ngashme mundësishët
- U mbështet në vlerësimin e saj nëse qiratë janë të vështira direkt pas dates së aplikimit filletar
- Aplikoi përashtimin për qiratë afatshkurtra që përfundon pas 12 muajsh nga data e aplikimit filletar
- Përashtoi kostot filletare direkte nga matja e aktivit e drejta-në-përdorim në datën e aplikimit filletar
- Përdori gjykimin në përcaktimin e kushteve të qirasë kur kontrata përbante opzionin për të shtyrë ose përfunduar qiranë

Më poshtë paraqitet një rakordim i angazhimeve totale të qirasë operative në 31 dhjetor 2018 (siç praqitet në pasqyrat financiare deri më 31 dhjetor 2018) me detyritet e qirasë të njoitura në 1 Janar 2019:

Angazhimet totale të qirasë operative më 31 dhjetor 2018	4,404,825
Përashtimet nga njojja:	
Qiratë e pasurive me vlerë të ulët	(3,129)
Qiratë financiare me afat të mbetur të qirasë më pak se 12 muaj	(26,257)
Rregullime të tjera në lidhje me shënimet shpjeguese të angazhimeve	12,121
Detyritet e qirasë operative para zbritjes	4,387,560
Zbritja duke përdorur normën rritëse të huamarjes	(1,348,029)
<b>Detyritet totale të qirasë të njoitura sipas SNRF 16 në 1 Janar 2019</b>	<b>3,039,531</b>

Miratimi i SNRF 16 nuk kishte asnjë ndikim në fitimet e pashpërndara të Grupit dhe asnjë ndikim material në raportin e tij CET1.

#### • Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Tatimin mbi të Ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kérkesat që lidhen me interesin dhe penalitetet që lidhen me pasigurinë në trajtimeve të tatimit.

Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një njësi ekonomike i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç
- Supozimet që një njësi ekonomike bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatueshëm (humbe tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një njësi ekonomike i konsideron ndryshimet në faktë dhe rrëthana

Grupi përcakton nëse do e konsiderojë çdo trajtim fiskal të pasigurtë veçantë apo sëbashku me një apo më shumë trajtime të tjera fiskale të pasigurta dhe përdor metodën që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë.

Grupi aplikon gjykim të rëndësishëm në identifikimin e paqartësive për trajtimet e tatim fitimit. Grupi vlerëson nëse një Interpretim ka pasur ndikim në pasqyrat e saj financiare. Me adoptimin e interpretimit, Grupi shqyrton nëse ka ndonjë pozicion të paqartë fiskal. Interpretimi nuk pati ndikim në pasqyrat financiare të Grupit.

# **Banka Credins sh.a.**

**Shënimë për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
(shuma në mijë Lekë, përvèç kur është shprehur ndryshe)

## **2. Politikat kontabel (vazhdim)**

### **2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)**

#### **2.3.1 Standarde të reja dhe të rishikuara dhe interpretime (vazhdim)**

- Amendime për SNRF 9: Specifikat e parapagimeve me kompensim negativ**

Nën SNRF 9, një titull borxhi mund të matet me kosto të amortizuar ose me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse, duke qenë e dhënë që flukset e kontraktuara të parasë janë 'vetëm pagesa principali dhe interesë mbi vlerën e mbetur të principalit' (kriteri i 'SPPI') dhe instrumenti mbahet brenda modelit të përshtatshëm të biznesit për atë klasifikim. Amendimet për SNRF 9 sqarojnë se një aktiv finanziar e kalon kriterin e SPPI pavarësisht ngjarjes apo rrethanave që shkaktojnë përfundimin e parakohshëm të kontratës dhe pavarësisht se cila pale merr ose paguan një kompensim të arsyeshëm për përfundimin e kontratës.

Përfundimi i hershëm mund të rezultojë nga një kusht kontraktual ose nga një ngjarje jashtë kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si një ndryshim në legjislacion që çon në përfundimin e hershëm të kontratës. Kur parapagimi është bërë më vlerën e drejtë aktuale ose në një vlerë që përfshin vlerën e drejtë të kostos së përfundimit një instrument mbrojtës të lidhur, Grupi vlerëson flukset specifike kontraktuale të parasë për titullin faktik të bondhit me qëllim që të përcaktojë nëse ata e përbushin kriterin e SPPI. Këto amendime nuk paten impakte të rëndësishme në pasqyrat financiare të Grupit.

- Reforma e masës së normës së interesit: Amendime të SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF**

Amendimet e SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 në lidhje me Reformën e masës së normës së interesit, përfshijnë një numër lehtësirash, që aplikohen për të gjitha marrëdhëniet e mbrojtjeve që janë të lidhura direkt me ndikimin e reformës së normës së interesit. Një marrëdhënie mbrojtëse ndikohet nga reforma nëse ajo sjell pasiguri në lidhje me kohën dhe ose vlerën e masës bazuar në flukset e parasë të zërit të mbrojtur ose instrumentit të mbrojtur.

Sic pëershruhet në politikat kontabile, Grupi zgjodhi, si zgjedhje politike të lejuar për SNRF 9, të vazhdojë të aplikojë kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNK 39. SNK 39 kërkon që për flukset e parasë të mbrojtura, një transaksion i parashikuar duhet të jetë shumë i mundshëm. SNK 39 kërkon gjithashtu që një marrëdhënie mbrojtjeje kualifikohet për kontabilitet mbrojtës vetëm nëse marrëdhënia është shumë efektive në arritjen e ndryshimeve kompensuese në vlerën e drejtë ose flukseve të parasë të lidhura me riskun e mbrojtur. Vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes bëhet në mënyrë retrospektive dhe prospективë.

Si rrjedhojë e reformës së masës së interesit, mund të ketë pasiguri në lidhje me kohën dhe ose vlerën e masës e flukseve të parasë bazuar tek masa të zërit të mbrojtur ose të instrumentit të mbrojtur gjatë periudhës përpara zëvendësimit të një mase norme interesë ekzistuese me një alternative pothuaj pa-risk norme interesë (një NPR). Kjo mund të cojë në paqartësinë nëse një transaksion parashikimi ka shumë mundësi të ndodhë dhe nëse në mënyrë prospективë marrëdhënia mbrojtëse pritet të jetë shumë efektive. Grupi nuk e ka adoptuar herët këtë amendim por parashikon që nuk do ketë efekte material në pasqyrat financiare të saj.

#### **2.3.2 Standarde dhe interpretime të publikuara por jo në fuqi**

Standarde dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara që janë publikuar, por jo ende efektive, deri në datën e preqatijes së pasqyrave financiare të Grupit paraqiten më poshtë. Grupi ka për qëllim ti adoptojë këto standarde, nëse janë të mundshme, në datën kur ato bëhen efektive.

- SNRF 17 Kontrat e sigurimit**
- Amendimet e SNRF 3: Përcaktimi i një Biznesi**
- Amendime për SNK 1 dhe SNK 8: Përcaktimi i Materialitetit**
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar**

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillostar dhe për këtë arsy nuk janë përgatitur shenime shpjeguese.

# Banka Credins sh.a.

Shënimë për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

## 2. Politikat kontabel (vazhdim)

### 2.4 Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

#### 2.4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, transaksionet në valuta të ndryshme nga monedha funksionale e Grupit njihen në kursin e këmbimit të çastit në datën e transaksioneve.

Transaksionet në monedha të huaja përkthehen në monedhën përkatëse funksionale të operacionit në kurсин e këmbimit në vend në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja në datën e raportimit janë ri-konvertuar në monedhën funksionale me kurсин e këmbimit në vend në atë datë. Fitimi ose humbja në valutë në artikujt monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e regulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston e amortizuar në valutë të përkthyer me kurсин e këmbimit në vend fundi i periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare që maten në terma të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursi e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lekë ndaj një njësie të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
USD	108.64	107.82
Euro	121.77	123.42
GBP	143.00	137.42
CHF	112.30	109.60
CAD	83.38	79.22
XAU	5,318.79	4,447.64

#### 2.4.2 Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme

##### 2.4.2.1 Data e njohjes

Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare, me përashtim të kredive dhe paradhënieve dhëne klientëve janë njohur fillimisht në datën e transaksionit, datë kur Grupi bëhet palë e dispozitive kontraktuale të instrumentit. Loans and Kredite dhe paradeniet dhene klienteve njihen kur fondet transferohen tek illogarite e klienteve. Grupi njeh detyrimet ndaj klienteve kur fondet janë transferuar tek Grupi.

##### 2.4.2.2 Matja fillestare e instrumentave financiarë

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga kushtet e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për menaxhimin e instrumenteve, siç përshtkuhet në shënimet 2.4.4.1.1 dhe 2.4.4.1.2. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë (siç përcaktohet në Shënimin 2.4.3), përveç rasteve kur aktivet financiare dhe detyrimet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH), kostot e transaksionit shtohen ose zbriten nga kjo shumë. Të arkëtueshem tregtare maten me çmimin e transaksionit. Kur vlera e drejtë e instrumenteve financiare në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Grupi illogarit fitimin ose humbjen e ditës së parë, siç përshtkuhet më poshtë:

##### Fitimi ose humbja në ditën e parë

Kur çmimi i transaksionit të instrumentit ndryshon nga vlera e drejtë e origjinës dhe vlera e drejtë bazohet në një teknikë vlerësimi duke përdorur vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Grupi njeh dallimin midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit. Në rastet kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë zhvlerësohet dhe njihet në fitim ose humbje vetëm kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

##### 2.4.2.3 Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare

Grupi i klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe kushteve kontraktuale të aktivit, të matura me:

- Kosto të amortizuar, siç shpjegohet në Shënimin 2.4.4.1.
- Vlerën e Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse ("VDATGj"), siç shpjegohet në Shënimet 2.4.4.4 dhe 2.4.4.5
- Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH), siç shpjegohet në Shënimin 2.4.4.6.

Grupi klasifikon dhe i mat derivatet e portofolin e saj të tregtimit me VDPFH siç shpjegohet ne Shënimet 2.4.4.2 dhe 2.4.4.3. Grupi mund të caktojë instrumenta financiarë me VDPFH, nëse kështu eliminon ose ul ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes, siç shpjegohet në Shënimin 2.4.4.6.

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të huasë dhe garancive financiare, maten me koston e amortizuar ose me VDPFH kur ato mbahen për tregtim dhe instrumenta derivative ose zbatohet përcaktimi i vlerës së drejtë, siç shpjegohet në Shënimin 2.4.4.6.

# **Banka Credins sh.a.**

**Shënim për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(shuma në mijë Lekë, përvèç kur është shprehur ndryshe)*

---

## **2. Politikat kontabel (vazhdim)**

### **2.4 Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **2.4.2 Instrumentat financiarë – njojja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)**

##### **2.4.2.4 Çregjistrimi i aktiveve financiare**

###### **2.4.2.4.1 Mosnjohja për shkak të modifikimit thelbësor të termave dhe kushteve**

Grupi çregjistron një aktiv financiar, të tillë si një hua për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegocuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferençën e njoftim ose fitim ose humbje nga mosnjohja e fitimit ose humbjes, në masën kur një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njoftura klasifikohen si Faza 1 për qëllimet e matjes ECL, përvèç rasteve kur kredia e re konsiderohet të jetë POCI.

Kur vlerëson nëse duhet ta njoftë ose jo një kredi për një klient, ndër të tjera, Grupi merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë;
- Prezantimi i nje karakteristike kapitali;
- Ndryshimi në palen tjetër;
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përbushë më kriterin e SPPI.

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse të mjeteve monetare që janë thelbësish të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me normën efektive të interesit në origjinë, Grupi regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar. Për detyrimet financiare, Grupi merr në konsideratë një modifiko të bazuar në thelb në faktorët cilësorë, dhe nëse kjo rezulton me një diferençë prej, ose më shumë se dhjetë për qind midis vlerës aktuale të përshtatur e të skotuar dhe shumës fillestare të detyrimit financiar. Për aktivet financiare ky vlerësim bazohet në faktorët cilësorë.

###### **2.4.2.4.2 Çregjistrimi përvèçse për ndryshime thelbësore**

###### **2.4.2.4.2.1 Aktivet financiare**

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose një pjesë të një grupei të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Grupi gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ka transferuar aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim. Grupi ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Grupi ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar;
- Ose
- Ajo ruan të drejtat e flukseve të mjeteve monetare, por ka marrë përsipër detyrimin për të paguar flukset monetare të marra në tërësi pa vonesë materiale për një palë të tretë sipas një marrëveshjeje të "kalimit".

Marrëveshjet e kalimit janë transaksione ku Grupi ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për t'ia paguar këto flukse monetare një ose më shumë subjekteve ('përfituesit eventualë'), kur plotësohen të trija kushtet e mëposhtme:

